



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

02-060/01-0042000-4/26

29.07.2026



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0042000-4/26 dt. 29.07.2026

Mitrovicë

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d, dhe nenit 40, paragrafi 2, pika c, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenit 13, paragrafi 1, pika 1.4, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenin 3 paragrafi 1, 2 dhe 5 i Rregullores Komunale Nr. 08/2023 Për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe granteve; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 29.07.2026, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0041998-4/26 dt. 28.07.2026); sjell këtë:

VENDIM

Për mbështetje financiare (subvencionim) të z. Sabri Çabra

1. MIRATOHET Vendimi për mbështetje financiare të z. Sabri Çabra, sportist i suksesshëm në sportet për persona me aftësi të kufizuara, Kampion i Kosovës në kategorinë BC2 dhe fitues i Turneut të parë të Kampionatit Boccia 2026 dhe në shenjë të vlerësimit për suksesin e tij dhe përfaqësimin e denjë të Mitrovicës dhe Kosovës, i cili po ashtu do ta përfaqësojë Republikën e Kosovës në World Boccia Challenger-Pilsen 2026.
2. Sipas pikës 1, të këtij vendimi, Z. Sabri Çabra mbështetet me mjete financiare prej 500.00 (pesëqind) € nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere – Drejtoria për Mirëqenie Sociale.
3. Mjetet e lejuara sipas pikës 1 të këtij vendimi do të barten në xhirollogarinë e z. Sabri Çabra.
4. Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë



Kryesuesi i Kuvendit

Saifet KAMBERI

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 MAPL-së
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje: Kryetarit të Komunës
- DBF-së
- DMS-së